

Deri te:

Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës

Në bazë të vendimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës, me nr.19-43/5 nga mbledhja e mbajtur me datën, 21.09.2022 për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull: “Ndikimi i forcës eksplozive në efikasitetin e rezultateve të kercimi se larti”, të kandidatës MSc. Blerta Abazi, Komisioni në përbërje të: 1.Prof. Dr. Fadil Rexhepi - anëtar; 2.Prof. Dr. Hyjnor Kica – anëtar, 3.Doc. Dr. Alim Hajredini - anëtar; 4.Doc. Dr. Laureta Abazi - anëtar;5.Prof. Dr. Isa Asllani - mentor, pasi lexoj materialin në dorëshkrim, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike i paraqet këtë

RAPORT

Për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Të dhënat biografike të kandidatës:

Blerta Abazi ka lindur në Skënderaj me: 06.03.1989, shkollën fillore ka përfunduar në fshatin Turiqec, shkolla “Abedin Rexha” , ndërsa studimet e Shkollëse mesme, i ka përfunduar në Gjimnazin Shoqëror në shkollën e mesme “Hamëz Jashari” në Skënderaj. Ndërsa studimet universitare i ka përfunduar në fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës në vitin 2010. Në po të njëjtin vit dhe në të njëjtin Universitet ka regjistruar studimet posdiplomike Master, të cilat i ka përfunduar në vitin 2013, duke marrë kështu titullin Master i Shkencave Sportive në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit, në Universitetin e Prishtinës.

Përvoja personale:

Që nga fëmijëria është marrë me sportin e pingpongut, ku për 12 vite ishte lojtarë e rregullt në klubin e pingpongut “Shpresa” – Turiçec. Për 3 vite me radhë ishte Kampione e Kosovës (kategoria - juniorë dhe seniorë), gjithashtu anëtare e përfaqësueses së Kosovës për 5 vite radhazi me grupmoshat e reja dhe seniorët në Kampionatet Evropiane: Kroaci, Bosnjë, Sllovaki, Itali, Gjermani, e gjithashtu pjesëmarrëse edhe në Kampionatet Botërore në Hungari, Kinë e Japoni.

Në vitin 2011- ka përfunduar me sukses kursin për trajnerë të pingpongut i organizuar nga Federata Ndërkombëtare e Ping-pongut (ITTF), e në po të njëjtën kohë ishte e angazhuar edhe si trajnere për grupmoshat e reja në Klubin e ping-pongut “Shpresa”.

Për 3 vite ishte anëtare e bordit në Federatën e Pingpongut të Kosovës.

Që nga viti 2010 e deri më tani, është e angazhuar në cilësinë e asistentes së rregullt në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit në Kolegjin AAB duke ligjëruar lëndët: Ping-pong dhe Fitnes.

Ka qenë mentor dhe anëtare e komisioni në më shumë se 40 punime të diplomave Bachelor në programin Kulturë Fizike dhe Sport - “Kolegji AAB”.

Deri më tani, Msc. Blerta Abazi ka marrë pjesë në disa Konferenca Shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe gjithashtu ka të publikuara një numër të konsiderueshëm të punimeve shkencore.

Në vazhdim po i paraqesim disa nga punimet shkencore dhe profesionale të publikuara në revista kombëtare dhe ndërkombëtare:

1. Abazi, B (2020) The impact of marital status in physical activity of women in Kosovo. *The Scientific Journal SPORT AND HEALTH*, vol.7 Nr.13-14
UDC 796.03-058.8-055.2 (497.115)
2. Abazi, B., Gashi, B., Pireva ,F., Maqedonci.V (2019) Dependency on cell phone (Internet) and its impact to the learning process and to the physical activity among sports students in AAB College. *Sportski Logos ,Scencific Journal* vol.17, issue 31, 2019. SSN 1512 – 875X ISSN 223 – 0852

3. Pireva,F., Abazi.B., Stankovska,Z., Xhemajli.A.,Gashi.B., (2020) Differences in some motor skills between students of Faculty of Physical Education and Sport of University of Prishtina and AAB College. *International Scientific journal of Kinesiology*. Vol. 12, Issue 1. June 2019 Print ISSN 1840-3662, Web ISSN 1840-3670UDK 796, Catalogued in: COBISS BH
4. Abazi,B., Xhemajli, A.,³ Halilaj, F.,² Pireva,F., (2019)Differences in some athropometric characteristic and motor skills between students of Faculty of Physical Education and Sports of University of Prishtina adn AAB College. *The Scientific Journal SPORT AND HEALTH*, vol.6UDC:796.012.077.5:572.087.1(497.115)
5. Berisha. M , Abazi. B (2021) Determining the norm values of table tennis in motor and technical 2 tests in male students aged between 7-9 and analyzing differences. *Viref Revista de Educación Física*, Instituto Universitario de Educación Física y Deporte ISSN 2322-9411 • Julio-Septiembre 2021 • Volumen Número 3.10
6. Abazi,B., Xhemajli, A.,³ Halilaj, F.,² Pireva,F., (2019) Differences in some athropometric characteristic and motor skills between students of Faculty of Physical Education and Sports of University of Prishtina and AAB College. International Balkan konference of Sport Sciences. University of Tetotvo
7. Abazi Blerta (2020). Transformation and Consequences in Society due to Covid-19 Pandemic. Virtual International Academic Conference AAB College, Prishtina, Kosovo.
8. Abazi Blerta (2021). The impact of marital Status in Physical Activity of women in Kosovo. International Conference in Sport ScienceAAB College, Prishtina, Kosovo.

Në vitin 2016 ka regjistruar studimet e doktoraturës në Univrsitetin e Tetovës, në fakultetin e Kulturës Fizike – drejtimi Kineziologji. Pas perfundimit të të gjitha provimeve, ka përgatitur projektin e temës së disertacionit të doktoratës me titullin: **Ndikimi i forcës eksplozive në efikasitetin e rezultateve në kërcimin se larti**, me mentor, Prof. Dr. Isa Asllani. Që si qëllim ka pasur : Vlerësimin e efekteve të programit stërvitor eksperimental, i orientuar në përkryerjen e bazave për zhvillimin e treguesve të forcës shpërthyes-eksplozive dhe dallimet e grupit eksperimental (E) dhe grupit kontrollor (K) në raport me ndikimin e tyre në rritjen e rezultateve të kërcimit se larti, teknika gërshtëre. Me aplikimin e një programi specifik stërvitor me një grup nxënësish të vërtetohen dallimet në mes të dy grupeve atë eksperimental dhe grupit kontrollor në hapësirën morfologjike dhe motorike si dhe në suksesshmërinë e përfundimit të kërcimit se larti, teknika “gërshtëre”.

Në **Hyrje** të këtij punimi autori ka sqaruar se ky hulumtim përqëndrohet kryesisht në fushën mësimore-stërvitore, duke pas për qëllim rritjen e treguesve të forcës, posaçërisht forcës shpërthyes (eksplozive) dhe formave të tjera të shfaqjes së saj, si dhe lidhjet reciproke ndërmjet këtyre aftësive motorike me rezultatet atletikore.

Në mungesë të hulumtimeve të duhura të kësaj moshe dhe të kësaj lëmie në Kosovë, autorja në fjalë ka përzgjedhur popullatën e të rinjëve të moshës 16 vjeçare të meshkujve për të qenë pjesë e këtij hulumtimi.

Pra ky studim ka për qëllim që përmes aplikimit të një programi të veçantë stërvitor me një grup nxënësish të vërtetohen dallimet në mes të grupit eksperimental dhe grupit kontrollor në hapësirën morfologjike dhe motorike si dhe në suksesshmërinë e ekzekutimit të kërcimit se larti.

Në mënyrë të veçantë autorja ka trajtuar historikun i kërcimit se larti dhe gjithashtu në këtë pjesë autori ka cekur edhe synimet e pjesës së hulumtimit.

Në **kapitullin e parë** –ka paraqitur konceptin teorik të punimit. Autorja fillimisht ka shpjeguar analizën e strukturës lëvizore të kërcimit se larti (varianti shkollor gërshtëre), duke elaboruar fazat e kërcimit veç e veç. Në vijim autorja ka shpjeguar nocionet bazë, fillimisht definimin e hapësirës antropometrike-morfologjike, më pastaj ka shpjeguar strukturën e aftësive motorike, siç janë: forca,

qëndrueshmëria, shpejtësia, agjiliteti, koordinimi, fleksibiliteti, drejtpeshimi etj. Po ashtu në këtë kapitull autorja ka paraqitur edhe pasqyren e disa hulumtimevetëautorëve të ndryshëm që kanë të bëjnë me ndikimin e karakteristikave morfologjike dhe aftësive motorike të kërcimi se larti.

Në **kapitullin e dytë** – autorja ka përcaktuar lëndën e hulumtimit e cila ka një rëndësi shumë të madhe, sidomos kur bëhet fjalë për këtë fushë të studimit. Lënda e këtij hulumtimi është orientuar në organizmin e punës, përmbajtjen dhe zbatimin e saj në zhvillimin e forcës shpërthyes-eksplozive, në funksion të rritjes së rezultateve në kërcim se larti të teknika shkollorë “gërshërë”. Nëpërmjet aplikimit të një programi specifik stërvitor, me një grup nxënësish do vërtetohen dallimet mes dy grupeve: atë eksperimental dhe kontrollor, në hapësirën motorike dhe morfologjike si dhe në sukseshmerin e ekzekutimit të kërcimit se larti.

Në hipotezat e hulumtimit janë përfshirë pesë hipoteza, ndërsa në metodologjinë e hulumtimit është përfshirë mostra e entiteve prej gjithsej 220 nxënës vullnetar (meshkuj) të shkolles së mesme “British School of Kosova” të komunës së Prishtinës (Kosovë) të moshës 16 vjeçare (± 6 muaj). Nëpërmjet aplikimit të metodës së rastit, mostra prej 220 nxënësve, është ndarë në dy grupe: - Grupi eksperimental (GE), me 110 nxënës dhe – Grupi i kontrollit (GK), me 110 nxënës. Me grupin eksperimental është zbatuar një program i veçant stërvitor 12 javor. Në hulumtim janë përfshirë gjithsej 35 ndryshore. Në hapësirën antropometrike ka aplikuar 18 ndryshore, ndërsa në hapësirën motorike 17, duke përfshirë këtu edhe variablen kriter – Kërcimin se larti, tekniken shkollorë “Gërshërë”. Autori i përshkruan të gjitha variablat veq e veq, të cilat janë të standardizuara dhe të aplikuara edhe më heret nga autoret e ndryshëm.

Sa i përket instrumenteve matëse të aplikuara gjatë relizimit të testimeve, përveq mjeteve bazike, janë përdorur edhe disa instrumente të fjalës së fundit të teknologjisë, si: peshorja e modelit (Tabita BC-545N), kohëmatësin digjital “Witty Timer ménages”.

Të dhënat statistikore janë përpunuar me programin IBM SPSS Statistics 21.0 software: Analiza Deskriptive ka përfshirë: Mean (Mesi aritmetik), Min (rezultati minimal), Max (Rezultati maksimal), Std. Deviation (Devijimi standard), Skewness, Kourtoosis. Korrelacioni mes variablave antropometrike dhe motorike dhe kërcimit se larti, teknikes shkollore gërshtë është dhen përmes analizës korelative. Për dallimet domethënëse statistikore ndërmjet grupeve të hulumtuara është përdorur analiza univariante e variantes (ANOVA) dhe multivariantë e variantës (MANOVA), gjithashtu për dallimet domethënëse statistikore ndërmjet grupeve të hulumtuara është përdorur edhe analiza univariant e kovariancës (ANKOVA) dhe analiza multivariantë e kovariancës (MANKOVA).

Përcaktimet e ndikimit të sistemit të treguesve morfologjike dhe testeve motorike në ato kriterike është realizuar nëpërmjet analizës regresive. Për secilën të dhënë (morfologjike dhe motorike) është përcaktuar korrelacioni kritik, korrelacioni parcial, koeficienti BETA. Në tërë sistemin e treguesve është llogaritur koeficienti i përcaktimit DELTA, korrelacionit multiple apo i shumëfishtë.

Në **kapitullin e tretë** – autori ka paraqitur interpretimet e rezultateve deskriptive të hapsires morfologjike dhe motorike ndërmjet grupit të kontrollit dhe grupit eksperimental, si në matjet para aplikimit të programit stërvitor, po ashtu edhe në matjet pas aplikimit të programit stërvitor. Përmes analizes comparative “repeated measure Anova-Manova” autori ka bërë dallimin në mes të testeve fillestare dhe finale në grupin eksperimental dhe kontrollues (differences within subjects, MANOVA) dhe dallimin mes grupit kontrollues dhe eksperimental në testet fillestare dhe finale (differences between subjects ANCOVA). Gjithashtu autori në këtë kapitull ka përfshirë analizen e korelacionit ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike dhe teknikes së kërcimit se larti. Përmes analizes Regresive ka bërë përcaktimin e ndikimit të sistemit të treguesve morfologjik dhe testeve motorike në ato kriterike.

Në **Kapitulline katërt** dhe të fundit është paraqitur diskutimi i gjetjeve të hulumtimit, ku janë analizuar krahasimet ndërmjet matjeve në kohë, pra matjeve të realizuara para aplikimit të programit dhe matjeve të realizuara pas aplikimit të

programit stërvitor dhe ndermjet grupeve, grupit eksprimental dhe grupit të kontrollit. Gjithashtu janë analizuar edhe efektet e programit stërvitor në rritjen e performancës te kercimi se larti, po ashtu autori ka krahasuar gjetjet e punimit me ato të autorëve të ndryshëm, si në hapësirën morfologjika ashtu edhe në atë motorike. Në këtë kapitull autori gjithashtu bënë analizimin dhe vertetimin e hipotezave duke u bazuar në rezultatet e këtij punimi shkencorë.

- I. **Përfundimi**-Në përfundim të këtij disertacioni, autoria në bazë të rezultateve të fituara bënë një përmbledhje të tërë punimit me përfundime dhe rekomandime për hulumtuesit shkencorë: Rezultatet e fituara tregojnë se tretmani kineziologjik apo stërvitja sportive në atletikë synon arritjen e rezultateve sportive përmes zhvillimit dhe përmirësimit të formës sportive. Megjithatë, nuk ka menaxhim optimal të formës së arritur nëse nuk i dimë të gjithë faktorët nga të cilët varet rezultati, në rastin konkret në kërcimin së larti teknika gërshërë. Para fazës operacionale në teknologjinë e stërvitjes, pyetja e parë që lind është: *Cilat janë karakteristikat morfologjike dhe aftësitë motorike nga të cilat varet rezultati sportiv*. Nëse kjo nuk dihet, menaxhimi i procesit të stërvitjes sportive nuk është i mundur. Prandaj, vetëm pas përcaktimit të karakteristikave dominuese antropologjike për një degë të caktuar sportive, mund të fillohet programimi i stërvitjes. Është e pamundur të programosh me sukses stërvitjen nëse nuk kemi sa më shumë informacion që të jetë e mundur për faktorët nga të cilët varet efikasiteti ose suksesi në një sport të caktuar. Në kushte të tilla, ndodh puna intuitive dhe spontane. Vetëm ato karakteristika antropologjike që janë drejtpërdrejt përgjegjëse për arritjen e një rezultati sportiv dhe që individi i posedon natyrshëm. Është shumë e rëndësishme të kemi informacion për kushtëzimin gjenetik të secilës prej tipareve, aftësive dhe karakteristikave të rëndësishme, konkretisht të forcës eksplozive e cila varet shumë nga faktorët gjenetik. Ajo që është gjenetkisht shumë i kushtëzuar, pra që ka një koeficient të lartë të trashëgimisë ka një aftësi të kufizuar për të ndryshuar nën ndikimin e stërvitjes sportive. Kjo do të thotë konkretisht se nëse në strukturën hierarkike të tipareve, aftësive dhe karakteristikave nga të cilat varet rezultati sportiv, ekziston një me koeficient të lartë të trashëgimisë, sistemi i përzgjedhjes duhet të synojë të identifikojë ata persona që e kanë këtë karakteristike antropologjike "natyrshëm" shumë te zhvilluar.

Literatura:






Në këtë studim janë dhënë gjithësej 95 burime në lidhje me problematiken e studimit. Referencat janë nga utorë të vendit dhe të huaj.

Përfundimi dhe propozimi nga komisioni

Punimi i disertacionit të doktoraturës me titull: **Ndikimi i forcës eksplozive në efikasitetin e rezultateve të kërcimit se larti**, të kandidatës MSc. Blerta Abazi sjellë një hulumtim shkencor në fushën e kineziologjisë, gjegjësisht në fushën e atletikës. Përmes analizave statistikore dhe rezultateve të fituara të këtij hulumtimi shkencor në lëmin e atletikës, kandidatja paraqet punën hulumtuese të jashtëzakonshme dhe jep një kontribut shkencor të kësaj kategorie- nxënësve të moshës 16 vjeçare, duke hulumtuar efektin e veprimtarisë mësimore-eksperimentale dhe ndikimin e forcës eksplozive në rezultatet e kërcimit se larti dhe përmes krahasimeve të grupeve dhe të matjeve në kohë ka treguar se si ka ndikuar zhvillimi i një programi pliometrik 12 javorë në përmirsimin e ndryshoreve morfologjike dhe motorike dhe në efektet e rezultateve të kërcimit se larti, të teknika shkollore gërshërë.

Në bazë të këtij raporti që është dhënë më lart: Komisioni për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull : **Ndikimi i forcës eksplozive në efikasitetin e rezultateve të kërcimit se larti**, të kandidatës MSc. Blerta Abazi, konstaton se ky disertacion i doktoraturës i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara dhe i propozon Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës që të aprovoj këtë raport të vlerësimit të disertacionit të doktoraturës dhe të lejoj për mbrojtjen publike.

Komisioni:

1. Prof. Dr. Fadil Rexhepi - anëtar 
2. Prof. Dr. Hynor Kica- anëtar 
3. Doc. Dr. Alim Hajredini- anëtar 
4. Doc. Dr. Laureta Abazi - anëtar 
5. Prof. Dr. Isa Asllani - mentor. 

Tetovë, Tetor 2022